



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr.502/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesues, Adnan Konushevcı dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore, Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) për shkak të mbajtjes së tubimit elektorale në ambient të mbyllur për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 16.02.2021, mori këtë:

#### V E N D I M

**HIDHET** e pa rregullt ankesa Anr.502/2021, e datës 15.02.2021, e parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Junik, për shkak të mbajtjes së tubimit elektorale në ambient të mbyllur për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021.

#### A r s y e t i m

Me datën 15.02.2021, Paneli, ka pranuar ankesën Anr.502/2021, të parashtruar nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendon se subjekti politik AAK ka mbajtur tubim elektorale në ambient të mbyllur në motel Gjeravica në Junik në të cilin pretendojn se kanë marrë pjesë mbi 50 persona ku shihen edhe fotografit të cila nuk kanë as distancë si dhe masa mbrojtëse (maska) duke i shkelur masat dhe ligjet për pandeminë Covid 19. Parashtruesi i ankesës thekson se organet kompetente ishin pjesëmarrës dhe nuk pranuan të ndalin tubimin edhe pse në ligj për pandeminë thuhet se në një tubim në ambient të mbyllur marrin pjesë më shumë se 30 persona. Parashtruesi i ankesës thekson se pjesëmarrësit të tubimit ishin Ramush Haradinaj Teuta Haxhiu, Pal Lekaj Shkumbin Demaliaj etj.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

#### **Ankesa është e parregullt**

Paneli, nga shkresat e lëndës vlerësoi se ankesa e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), është e parregullt, sepse ankesa në fjalë nuk është e nënshkruar nga parashtruesi i ankesës dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kërkesat ashtu siç parashihet me nenin 5.6 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, ku theksohet se: *“Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari”*. Në rastet kur ankuesi është parti politike, koalicion,

*iniciativ qytetare ose çfardo personi tjetër juridik, ankesa duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i atij personi juridik siç është përcaktuar, në rastet ku kjo është e mundshme, në çfardo dispozite ligjore në fuqi.*

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëcekur.

Nga arsyet e lartëcekura e në mbështetje të nenit 5.6 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr.502/2021 më datën 16.02.2021.



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*